



VENDIM

Nr. 64, Datë 27.05.2016

**PER FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE
MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PERCAKTIMIT TË ÇMIMIT
TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I
MUNDËSISË SË FUNDIT,**

Ne mbështetje të nenit 16, nenit 21 dhe nenit 87 pika 4 të ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenit 25 të *Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s*, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.05.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e “draft – Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” të përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e “draft – Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI